

**BASHKIA VAU DEJËS**  
NJOFTIM FITUESI

Autoriteti i Dhënies me Qira: Bashkia Vau Dejës njofton se në konkurrimin Publik të zhvilluar me datën 12.02.2024, ora 10:00, publikimi i të cilit është bërë me datën 29.01.2024 në Buletinin e Prokurimeve Publike nr.4, me objekt dhënie me qira:

Fillimi i procedurave për dhënie me qira per 10 (dhjetë) vite, me anë të konkurimit publik për sipërfaqen në total 31.03 ha e ndarë në 5 lote, konkretisht LOTI III me sipërfaqe prej 2.894146 ha, e shtrirë në pasurinë nr 738, zk 3769, në fshatin Vig, “Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linjë të

tensionit, aerogjenerator dhe fotovoltai(stacionet, bazamentet, objektet përkatëse etj)”, sipas Udhëzimit nr.1, datë 9.6.2016, “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullor Publik”.

Vlera fillestare:

Çmimi dysheme i fillimit të konkurrimit është 176.000 ( njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë/ha në vit për sipërfaqe të llojit “Livadh(Kullote)” dhe për 2.894146 ha është 509.369,7 (pesëqind e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë presje shtatë)lekë në vit për sipërfaqe të llojit “Livadh(Kullote)”, e përlogaritur kjo sipas VKM-së nr. 559, datë 29.7.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”, dhe sipas Raportit mbi Studimin Tekniko-Ekonomik, përgatitur nga specialistët e fushës.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurën përkatëse të konkurrimit publik këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.Subjekti fizik “GJONI KALIVAC”shpk numri i NIPT-it L68414501P

Oferta e paraqitur për dhënien me qira të sipërfaqes prej 2.894146 ha e shtrirë në pasurinë nr 738, LOTI III, “Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linjë të tensionit, aerogjenerator dhe fotovoltai(stacionet, bazamentet, objektet përkatëse etj)”, me afat përdorimi(qiraje) 10 vite është prej 520.964,28 (pesëqind e njëzet e katër mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër presje njëzet e tetë) lekë në vit pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. S’ka të skualifikuar  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Duke ju referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë:

1. Subjektin “GJONI KALIVAC”shpk

Adresa: Lezhë, Zejmen , Tresh, Lagjia Barbulloje, Rruga Kryesore Lezhë-Tiranë, Ndërtesë Private 2 kat, në zonën kadastrale 3641,nr i pasurisë 59/90, se oferta e paraqitur, për sipërfaqen prej 2.894146 ha , e shtrirë në pasurië nr 738, zk 3769, në fshatin Vig, “Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linjë të tensionit, aerogjenerator dhe fotovoltai(stacionet, bazamentet, objektet përkatëse etj)”, me afat përdorimi (qiraje) 10 vite, me oferte prej 520.964,28 (pesëqind e njëzet e katër mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër presje njëzet e tetë) lekë në vit pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht jeni të lutur të paraqisni pranë Bashkisë Vau Dejës, me adresë: Rruga Qafa e Gurit, Vau Dejës dhe referencë kontakti zyrën e sektorit të Prokurimeve Publike, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, sic parashikohet në dokumentat e konkurimit publik, brenda 10(dhjetë) ditëve nga dita e marjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqen nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siigurimi i ofetës suaj, sic parashikohet në Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 14.02.2024